

Vendim nr. 274 datë 12.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 12.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 35 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARTIAN ADIL**, përfaqësuar nga avokat Olsi Manosopi, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-4326 (356), datë 02.11.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 17, 18, 30, 33, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Artian Adil prej datës 13.07.2010 ka gëzuar statusin e nëpunësit civil, për pozicionin inspektor i parë, në sektorin e verifikimit në terren, ndërsa ka qenë i punësuar në pozicionin oficer në sektorin e Policisë Tatimore në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT), Korçë.

2. Me shkresën nr. 1534 prot., datë 28.03.2014, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka njoftuar Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) se në përfundim të verifikimeve të kryera për deklaratat e interesave privatë të kërkuesit dhe të dhënave të siguruara gjatë procesit të kontrollit të plotë, janë konstatuar probleme në lidhje me pasurinë e deklaruar nga bashkëshortja e tij dhe se në zbatim të nenit 15, shkronja “b”, të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (ligji nr. 9049/2003), si dhe të nenit 45 të ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (ligji nr. 9367/2005), ato përbëjnë shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësisë penale. Bazuar në problematikën e konstatuar nga ILDKPKI-ja, me vendimin nr. 912, datë 02.05.2014 (vendimi nr. 912/2014), drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ka vendosur lirimin e kërkuesit nga Shërbimi Civil, mbështetur në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ligji nr. 152/2013) dhe në ligjin nr. 9920, datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9920/2008).

3. Në datën 30.05.2014 kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, duke kërkuar: (i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 912/2014 të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve; (ii) zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë absolute të këtij akti administrativ, duke urdhëruar rikthimin e tij në punë dhe pagimin e pagës deri në momentin e rikthimit në detyrë. Sipas kërkuesit, lirimi i tij nga detyra është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, pasi shkelja e pretenduar nuk parashikohet nga ligji si shkak për lirimin nga Shërbimi Civil dhe se vendimi për lirimin nga Shërbimi Civil është marrë në tejkalim të kompetencave dhe procedurës, ndërsa ai nuk është dënuar penalisht sipas nenit 257/a, paragrafi 2, të Kodit Penal.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Korçë, me vendimin nr. 473, datë 09.09.2014, ka vendosur pranimin e padisë sipas objektit të saj. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, DPT-ja, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padisë.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 4719, datë 27.12.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, me arsyetimin se vendimi për lirimin nga Shërbimi Civil të kërkuesit është nxjerrë jo vetëm në kundërshtim flagrant me

ligjin, por edhe në kapërcim të kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 152/2013 për titullarin e autoritetit publik. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs pala e paditur, DPT-ja.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-4326(356), datë 02.11.2023, në dhomën e këshillimit, ka vendosur ndryshimin e vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta dhe rrëzimin e padisë së kërkuarit.

7. Në datën 22.07.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 12.08.2024. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuarit

8. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

8.1.1. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin e tij, i ka mohuar kërkuarit statusin e nëpunësit civil, të cilin e ka humbur për shkak të mosnjohjes së ligjit nga ILDKPKI-ja dhe nga DPT-ja, ndërkohë që ai kolegji nuk ka marrë në shqyrtim situatën e tij në lidhje me procedimin penal, ku me vendimin nr. 326, datë 06.12.2022, Kolegji Penal i asaj gjykate ka arritur në përfundimin se ai nuk mund të mbajë përgjegjësi për deklarime të cilat ligjërisht i takojnë bashkëshortes së tij.

8.1.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur prova*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e ka marrë vendimin në dhomën e këshillimit.

8.2. *E drejta për zhdëmtim*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin e tij, i ka mohuar kërkuarit të drejtën për përfitimin e një shpërblimi të drejtë për shkak të një akti të paligjshëm të organeve shtetërore, ndërsa ai kolegji ka gabuar edhe pse në rastin konkret jemi para pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të lirimit nga Shërbimi Civil.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuari të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

10. Kolegji vlerëson se kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

11. Kërkuari plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, pasi objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër ligjor për të shteruar për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara përveç kërkesës në këtë Gjykatë.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr.8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin

elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi është dhënë nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në datën 02.11.2023, kurse ankimi kushtetues individual është dërguar në Gjykatë në datën 19.07.2024, përmes shërbimit postar. Me informacionin e datës 10.10.2024, Gjykata e Lartë ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesi është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 16.12.2023, datë nga e cila është bërë i disponueshëm për palët. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij shqyrtimi, rezulton se kërkuesi është përfaqësuar në gjykimin në shkallë të parë nga një avokat, i zgjedhur me deklarament në seancë gjyqësore, i cili ka përgatitur edhe kërkesëpadinë e kërkuesit, në të cilën gjenden të shënuara edhe të dhënat elektronike të kontaktit të avokatit (*e-mail*). Ndërkohë, njoftimet për kërkuesin gjatë procesit gjyqësor në shkallë të parë dhe në apel i janë dërguar atij në adresën e vendbanimit. Po kështu, edhe njoftimi i rekursit të palës së paditur është bërë në të njëjtën mënyrë dhe pasi ajo ka dështuar për shkak se kërkuesi ka rezultuar i larguar jashtë vendit, njoftimi i këtij akti procedural është bërë me shpallje publike. Me shkresën nr. 523/1 prot., datë 23.05.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë i ka bërë me dije kërkuesit se në dosjen gjyqësore nuk ka akt njoftimi për vendimin e Gjykatës së Lartë, ndërsa i ka vënë në dispozicion një kopje të vendimit.

14. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se nën dritën e rrethanave të rastit konkret dhe duke pasur parasysh standardet e vendosura në lidhje me momentin e marrjes dijeni të vendimit që përbën mjetin e fundit ankimor, si datë e marrjes dijeni efektivisht për vendimin e Gjykatës së Lartë duhet të konsiderohet data 23.05.2024, në të cilën kërkuesit i është njoftuar vendimi i arsyetuar i asaj gjykate, për sa kohë ai vendim nuk i është njoftuar elektronikisht atij, avokatit të tij, megjithëse nga ky i fundit janë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Për rrjedhojë, kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor dhe kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, Kolegji konstaton se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe së drejtës për t'u dëgjuar, si dhe së drejtës për zhdëmtim, për shkak të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, me të cilën është vendosur ndryshimi i vendimeve të të dyja gjykatave më të ulëta dhe rrëzimi i padisë së kërkuesit.

16. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se vlerësimi i provave dhe problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues, nëse nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim përpara tyre nuk përbën lëndë kushtetuese (*shih vendimet nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në mënyrë konstante Gjykata ka pohuar se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë, të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 64, datë 01.10.2024; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Për sa më sipër, Kolegji vëren se, në rastin konkret, referuar argumenteve të paraqitura nga kërkuesi, konstatohet se ato, në thelb, kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit. Kërkuesi nuk ka arritur të argumentojë nga pikëpamja kushtetuese cenimin në të drejtat e tij kushtetuese për shkak të mënyrës se si ka vepruar Gjykata e Lartë, në rastin konkret, në shqyrtimin e çështjes për rekursin e palës kundërshtare të tij. Sipas Kolegjit Administrativ të asaj gjykate, referuar faktit se paditësi (kërkuesi) ka kundërshtuar vendimin për lirim nga Shërbimi Civil vetëm për shkaqe procedurale që lidhen me kompetencën dhe procedurën disiplinore, pa parashtruar asnjë pretendim për themelin e shkeljes, parregullsitë procedurale të ngritura nga ai nuk mund të passjellin pavlefshmërinë absolute të këtij akti, për sa kohë zgjidhja në thelb është e drejtë dhe nuk mund të ishte tjetër në kushtet kur jemi para një shkeljeje disiplinore shumë të rëndë, sipas nenit 57, pika 2, shkronjat “c” dhe “d”, të ligjit nr. 152/2013, parë në lidhje të ngushtë me nenin 45 të ligjit nr. 9367/2005, i cili moszbatimin e dispozitave të këtij të fundit e konsideron masë disiplinore më vete dhe përfshin brenda detyrës ligjore të zyrtarëve edhe plotësimin e saktë të deklaratës së pasurisë.

18. Nga ana tjetër, Kolegji vëren se kërkuesi nuk ka ngritur asnjë pretendim, për sa i përket marrjes dijeni për rekursin e palës tjetër dhe për pamundësinë e tij për të kundërshtuar pretendimet e ngritura në të përmes paraqitjes së kundërrekursit. Kolegji vlerëson se vetëm fakti se rekursi është shqyrtuar në dhomën e këshillimit nuk është i tillë që të vërë në dyshim respektimin e së drejtës për proces të rregullt, për sa kohë rezulton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar në përputhje me kompetencat e tij dhe me rregullat procedurale që gjejnë zbatim gjatë shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.